



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Kaçanik
Skupština Opština
Municipal Assambly
01Nr. 16-7946/2011
Kaçanik: 29.07.2011

Në bazë të nenit 11, 12.2(c) dhe 68.4 lidhur me nenin 40.2(a) të Ligjit nr. 03/L-040 -Për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare Nr. 2003/12, Udhëzimit Administrativ të MAPL 2008/9 për Transparencë në Komuna, të nenit 17 të Statutit të Komunës, me Rekomandim të KPF-a të datës: 25.07.2011 për Aprovimin e Draft-Rregullorës për transparencë Komunale 01Nr.16-7946 /2011, të propozuar nga kryetari i komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 29.07.2011, mori:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RREGULLORËS 01NR.16-7946/2011-PËR
TRANSPARENCË KOMUNALE

I.

APROVOHET Rregullorja **01Nr.16-7946/2011** me tekstin e mëtejshëm (Rregullorja për transparencë komunale) për komunën e Kaçanikut.

II.

Rregullorja si në pikën I. të këtij Vendimi ka për qëllim forcimin e transparencës komunale të organeve legislative dhe ekzekutive të komunës së Kaçanikut gjat ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi publike, angazhimit dhe rritjen e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje në nivel komunal si dhe lehtësimin e qasjes së publikut në dokumente zyrtare.

III.

Rregullorja e përcaktuar si në pikën I. të këtij Vendimi, është hartuar nga Zyra për Informim, përmban gjithsej : 11 nene dhe është pjesë përbërse e këtij Vendimi.

IV.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës.

V.

Më këtë Vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme, Zyra e Informimit, dhe Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Xhelal Gashi